ADEM ZAPLLUZHA

MENATË VIJNË LEJLEKËT

Redaktor:
Mazllum Baraliu

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

MENATË VIJNË LEJLEKËT

Shoqata e Shkrimtarëve
“Fahri Fazliu”
Kastriot, 2014

PROF. DR. MAZLLUM BARALIU

FJALA E REDAKTORIT TË LIBRIT

RECENSION

NJË VEPËR E RRALLË QË PJALMON KURAJO, DASHURI DHE HUMANIZËM

ADEM ZAPLLUZHA ”MENATË VIJNË LEJLEKET”- PËRMBLEDHJE ME POEZI, PRISHTINË 2014.

Adem Zaplluzha është njëri nga poetët më të angazhuar dhe më frytdhënës në letërsinë shqipe bashkëkohore të ne dhe gjithandej meridianeve ,ku krijohet dhe kultivohet fjala e bukur poetike Shqiptare. Nëse nuk gaboj,Odhise Grilo,njëri nga shkrimtarët më në zë të letërsisë shqipe të fundshekullit të njëzet – veçanërisht i letërsisë për fëmijë - ishte autor i rreth 110 titujve të veprave të botuara dhe nuk më kujtohet ndonjë autor tjetër i cili kaq më përkushtim,zell,energji të p shterrshme; passion, dashuri të patundur dhe të pafund, do ti dedikohet poezisë, sikur poeti ynë i mirënjohur, Adem Zaplluzha. Ai deri më tani ka botuar rreth 100 vepra me poezi të zhanreve të ndryshme;për të rritur dhe për fëmijë.

Puna e madhe përkushtuese dhe pasioni i paparë i tij për të shkruar dhe për t’i dhuruar lexuesit të vëmendshëm dhe të dashuruar në letërsi-veçmas në artin magjik të poezisë;fatkeqësisht nuk është

veneruar, studjuar dhe as vlerësuar as në minimumin e nevojshëm dhe të domosdoshëm, çfarë ky krijues cilësor dhe veteran i poezisë të ne e meriton. Produkcioni i tij letrar i gjertanishëm është i denjë edhe për shoqata,asociacione dhe madje edhe për akademi të tëra, të arteve e të shkencave të ndryshme;gjë që, gjer më tani, nuk na ka rënë të dëgjojmë ,se me të vërtetë ka ndodhur. Këtë barrë dhe këtë punë poeti Zaplluzha e ka bartur,rrjedhimisht e ka bërë pa përkrahje të duhur institucionale;pa hezitim,pa pritesë dhe pa imponim të askujt;thjeshtë për hir të nevojës dhe arsyes madhore për të ofruar,shërbyer dhe kontribuar në ndërtimin dhe latimin - deri në piedestal - të oreolit sublim kombëtar të artit; rrjedhimisht të letërsisë e të kulturës tonë ; në të mirë dhe dobi të qytetarit –lexues dhe ardhmërisë së tij perspektive.

Mirëpo ,shkas parësor dhe arsye për këtë shkrim sot,për poetin Zaplluzha,një sihariq i ri nga poeti ynë,është vepra e tij e radhës e titulluar**:" MENATË VIJNË LEJLEKET"**; vepër kjo e veçantë dhe e rëndësishme nga shumë aspekte,kënde dhe dimensione krijuese.

Në këtë përmbledhje me poezi për të rritur,autori ynë,në mënyrë specifike,por të drejtpërdrejtë, pa ekuivoke të shumta, shpupurisëse dhe indirekte;pa figuracione stilistike të padeshifrueshme,do të shpalosë,duke e vu në dispozicion të lexuesit të

vemendshëm, gjithë talentin e tij të pakontestueshëm ,sikurse edhe përvojën e gjatë e të pasur krijuese.

Vepra në trajtim e Zaplluzhës,është një përmbledhje me motive,frymëzime dhe tematika nga më të ndryshme;madje do të thoshim enciklopedike; me dobi, interes dhe kërshëri potenciale për lexuesin tonë. Po të veçonim disa nga motivet, temat dhe frymëzimet, nga të cilat dhe me të cilat preokupohet autori në këtë libër,sigurisht që së pari do të duhej nxjerr në pah:aktin e lindjes;lirinë e atdheun dhe të sakrificës për liri e për atdhe;ëndrrat fëmijërore dhe fëmijërinë;rrjedhimisht dëshirën e poetit për ta portretizuar rikthimin e tij imagjinar dhe metaforik në fëmijërinë e tij të paqenë- fëmijërinë të pa fëmijëri;dashurinë;lëvizjen;angazhimin aktiv dhe përparimin dinamik e progresiv në jetë(si ecje ;si lëvizje e pa ndalur përpara e jo përgjumje,amulli ,monotoni ,indiferencë dhe letargji -drejtë ardhmërisë individuale dhe kolektive –të njerëzve – qytetarëve të tij; në atdheun e lirë e të bashkuar;mërgimin-këtë plagë të shekujve dhe të mileniumeve për shqiptarët;por mbase edhe për të afërmit dhe familjarët e poetit;për vetminë si fenomen mjaftë specifik (dhe i padëshiruar) për poetin- (ani që ai në jetën e përditshme dhe jashtësisnë e sjelljes dhe qëndrimit ,në relacion me rrethin e tij familjar e shoqëror,tregohet dhe mbahet-kurdoherë dhe në vazhdimësi - intrasigjent

dhe i “pahetuar” e i paepur),si dhe për vdekjen si një fenomen tjetër relevant,por edhe përmbyllës i ciklit jetësor;për varfërinë,urinë dhe mëkatin e deri të universi si motiv dhe tematikë me porosi universale; me peshe dhe relevancë, për trajtim në poezitë e tij.

Procedimin e tij letrar,poeti në këtë përmbledhje sikur e fillon me një fanitje simbolike e cila përvijohet përmes **kënaqësisë që sjell liria e atdheut**. Në këtë fanitje sublime të lirisë ai sikur ndihet i realizuar dhe i kënaqur;pa ndier nevojë për asnjë lloj tjetër përmbushjeje. Në këtë kontekst ai shton**:”Nuk dua vdekje më të bukur,/se sa kjo kënaqësi/që shtrihet në krahun e djathtë/të fluturës së atdheut tim…**Nuk dua vdekje më të bukur /se sa kjo lindje/që i përket atdheut.(Poezia më lërë të vdes fq. 5).Mobilizimi motivues dhe frymëzues jashtëzakonisht i fuqishëm dhe në moment të caktuara edhe mjaftë shpërthyes,në këtë vepër ka rezultuar më një varg e vistër të figurimeve dhe transfigurimevfe stilistike;diskriptive dhe përmbajtësore; prurje me vlerë këto, të cilat e shtojnë në masë të konsiderueshme procedeun artistik deri në melodramacitet maksimal;fakt ky që ngrit nivelin e interesimit dhe adrenalinës së lexuesit dhe studjuesit të mirëfilltë të veprës letrare,për të absorbuar sa më shumë nga oferta mjaftë e pasur dhe laryshore e materjes poetike,në këtë përmbledhje me poezi. Ja vetëm disa nga shumë metafora mbresëlënëse të këtij libri,që

meritojnë një vëmendje të veçantë: “flokët e brymta të shirave(fq.12);qelin duart e lisave;rrënjët e Rrapit të dehidruar;lotët e erës;pikonte trishtimi (fq.13).;huazojnë qështjet e bronzta(fq.15);në katet e sipërme të mendjes (fq.16);shtrydhja e trishtimeve (fq.20);nëpër parathënien e muzgut (fq.23);si rropullitë e shpresave(fq.24.);nazalet e erës (fq24);serenatën e lëngut të mallëngjimit “(fq25);vashat lahen në lotët e hënës(fq.54)etj.

Duke qenë vetë tejet i vyeshëm, i palodhshëm dhe vazhdimisht dinamik e kontribut dhënës në avancimin e kauzës kombëtare dhe shoqërore ;poeti edhe nga të tjerët;pra nga bashkë kombasit e tij me shumë të drejtë,kërkon më shumë punë,mirëkuptim,dashuri,unitet,harmoni dhe mbi të gjitha përkushtim në ndërtimin e vendit dhe të shtetit të ri;konsolidimin dhe përparimin e atdheut;sepse ,sipas poetit tonë, :”përgjumja askujt nuk i bën mirë”(poezia: Dhe ata të tjerët,fq,10).Kjo përgjumje,nuk do ju bëj mirë madje as :”shokëve të luftës”(fq.26.str.3.,vargu 3.)sepse,poeti tërheq vëmendjen e lexuesit dhe vërejtjen e tij se :”të murishtat e shembura/po sillen vërdallë/disa mallkime hijesh të zeza/(poezia:Askush nuk fle sonte/.Poeti me këmbëngultësi kërkon që të mos ketë ngecje,por që të ecet domosdoshmërisht dhe me emulacion e vullnet të pashuar –përpara- deri në ngadhënjim e përparim **:”Ne duhet të ecim,bijtë e mi/domosdo duhet të ecim/Përtej ngadhënjimit të fjalës** (str. e 3 e poezisë: ”për ta mbërri

fundin”.,fq.50.,Autori ynë në këtë poezi dhe gjithandej kësaj përmbledhjeje,kërkon që të gjithë bashkë atdhetarët tanë –kudo ku janë, lypset të jenë më vigjilent dhe më përkushtues ndaj kauzës dhe progresit.

Në disa nga poezitë e tij,veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me qytetin e tij të lindjes-Prizrenin pitoresk, poeti Zaplluzha,sikur shpreh **nostalgjinë** e tij për të kaluarën dhe befasinë e pakëndshme për ndryshimet e gjeneratave ,që kanë ndodhur në ndërkohë ,si dhe zvetninë mbretëruese të një “vakumi shoqëror” atje. Duke ndier vakum edhe në zemër,ai sikur shpreh keqardhjen dhe habinë e tij,duke shtuar:”Paskan ikur/ose janë moshuar të njohurit/dhe të panjohurit/e qytetit të zambakëve(fq.16.str.2).Poeti ,përkundër ndiesisë së mirë dhe kënaqësisë që ndien kur e i viziton njerëzit e tij më të afërm dhe më të dashur të jetës në qytetin e tij të lindjes,në të njëjtën kohë ai sikur do të ndiej njëfarë lloj ftohtësie mornicore,sepse siç do të thotë katërcipërisht edhe ai vetë :”askënd nuk e njoh/Askush nuk më njeh sonte (në këtë qytet M.B.)(fq.17.,strofa e fundit).

Ndaj, në vjershën: ”Vetëm Shatërvani i vjetër(fq16).,autori me nostalgji dhe keqardhje, do të portretizojë tablotë e qytetit të tij ,me “ballkone të zbrazëta” dhe pa njerëzit e njohur për gjallërinë dhe bujarinë e tyre tradicionale mijëravjeçare ,që pritnin dhe përcillnin me mirëdashje maksimale

dhe me kënaqësi,të njohur e të panjohur,në shtëpitë e tyre të qytetit muze. Në qytetin e tij të lindjes e të rinisë së hershme-Prizrenin,kanë të bëjnë edhe poezitë:”Kur ishim të vegjël “(fq.71) dhe poezia përplot simbolikë dhe vetëspjegim:”Unë kam harruar kur isha fëmijë”(fq.72). të librit.

Duke u përballur “vetëm me dhembje”,me skamje dhe varfëri;por edhe me robëri e padrejtësi,poeti kishte vuajtur dhe ishte burrëruar para kohe. Duke e pasur një fëmijëri të tillë si shumë e shumë bashkatdhetarë të tij në Kosovë dhe viset tjera etnike autoktone pellazgo-iliro-shqiptare,poeti ynë zëshëm dhe pa keqardhje do të theksoj se :”asnjëherë nuk ishte i vogël apo fëmijë”,që do të thotë mbase se nuk kishte fare ose fare pakë fëmijëri të vërtetë dhe të mirëfilltë (fq.73.).Në këtë frymë autori ,sikur me shpirt të trazuar i drejtohet lexuesit si vijon:”Nuk më besoni por lindja ime /Ishte një trishtim i paharruar/nën rrogozin e vuajtjes/dhembja lëshonte gjëmën e përditshmërisë” (strofa 2 e poezisë: ”me plagë të pashëruara”, fq.61.

Duke qenë i mirënjohur nga rrethi i tij shoqëror, si njeri i popullit apoi masave të gjëra popullore,poeti këtë do ta dëshmojë edhe si krijues,jo vetëm në këtë përmbledhje,por pothuajse në gjithë opusin krijues –letrar të krijimtarisë së tij artistike.

Në vjershën :”Të varfëritë e qytetit tim”(fq.33.) psh.,(tani poeti mbase fjalën e ka për qytetin e tij – ku jeton e vepron me dekada të tëra-Prishtinën-),po ky i këndon me dhembje të madhe e keqardhje,por edhe me humanizëm të rrallë vegjëlisë së varfër dhe të pa përkujdesje as shoqërore dhe as njerëzore ,në ambientin e tij shoqëror.

Të varfëritë ,për poetin janë**: ”njerëz të mëdhenj; dinjitoz dhe optimist,** por që në dallim prej të tjerëve(të kamurve)këta të fundit dinë të kënaqën edhe më gjëra të imta; me një kafshatë bajate dhe të cilët me pakë bukë e kripë,si në mahi e tejkalojnë maratonën e urisë”. Atë ,pra autorin e përmbledhjes e preokupon dhe brengosë tej mase varfëria dhe skamja ekstreme e njerëzve të qytetit dhe të vendit të tij;Kosovës së tij të dashur. Prandaj edhe atyre ua kushton vëmendjen dhe kujdesin e duhur,edhe si poet edhe si njeri human.

Një lloj përkushtimi të tillë grandioz-me një ndiesi sublime-një përkrahje morale dhe humane, njerëzve të kësaj kategorie sociale, mund tua bëjnë vetëm poetët e mëdhenj e të përjetshëm (pra ata që duhet të mbesin përherë në memorien dhe altarin e shenjtë të popullit), bij autentik, të mirëfilltë e besnik të popullit të vetë.

Duke qenë mirënjohës dhe falënderues për njerëzit që e donë, respektojnë dhe e rrethojnë, autori i kësaj përmbledhjeje, në poezinë: ”Pa titull”(fq 30)

dhe “Nuk marr dot frymë pa ty”(fq39),nuk mendon për asgjë dhe as që i frikohet asgjëje tjetër ;madje as “vdekjes së plumbtë”,por ai sikur i druan :”zemrës së brishtë,por padyshim tepër të dashur e më të afërt,që ai ka pranë tij-bashkëshorten e tij”.Frika nga humbja e çfarëdoshme eventuale e saj;dashurisë,krenarisë dhe mbështetjes kryesore jetësore të tij,pra e më të afërmes së tij,është e kuptueshme që e shqetëson deri në trazim poetin;ngase me të dhe kryesisht vetëm me të, ndanë të gjitha gjërat më të rëndësishme që ofron dhe imponon jeta e përditshme. Poeti Zaplluzha brengoset shumë dhe preokupohet edhe me gjendjen e rendë të një amnezie; paknaqësie dhe të dëshprimit (kolektiv) të bashkëqytetarëve të tij dhe këtë gjendje ai e quan:” si një mallkim i hershëm”(shih vjershën me po këtë titull në fq.57 të librit),ndaj I indinjuar autori :”me plagë (ende) të pashëruara” i qorton ata të cilët me pahir përpiqen të ja ia imponojnë këtij modelin : ” se si duhet me e dashtë atdheun”(fq.61).Ndaj,më zë të fuqishëm kumbon:”O kush jeni ju të më mësoni/se si duken prangat/dyzet e katër vjet jetova i prangosur/si luani në kafaz/dhe akoma kam mbetur/me plagë të pashëruara…/Dhe ju sot me tregoni/Se si duhet me e dashtë atdheun/…,ndërkohë që unë,më tutje shton poeti,:”/Mbi katër dekada e barta gurin e pikëllimit/dhe gjumin kurrë nuk e pata gjumë/me sy të mbyllur e ëndërroja lirinë”.(strofa e fundit e poezisë “me plagë të pashëruara” (fq.61.).

Në poezinë me titull:”Më fal nëna ime”,poeti ,duke qenë i pakënaqur deri në zhgënjim me gjendjen e krijuar në ambientin;rrjedhimisht në realitetin objektiv që e rrethon atë edhe në shtetin e tij të lirë e të pavarur,pothuajse në zenit e ngrit zërin e tij të lamentimit dhe për këtë gjendje të rendë,të cilën ai e pasqyron realisht dhe sikur i kërkon falje vendit (nënës)së tij,të cilit i lutët për mirëkuptim,ngase pasi që e ka humbur durimin,tashmë më shumë iu përngjet “gurëve”,që asnjëherë nuk i ndalin vajet”(str. e fundit e poezisë :”më falë nëna ime” .,fq.82).

Fenomeni i **emigrimit,** tashmë shumë brengosës edhe në përmasa gjithëkombëtare,është ai që e preokupon tej mase poetin tonë; ashtu siç e preokupon dhe e shqetëson pothuajse çdo familje dhe individ, brenda hapësirës etnike Shqiptare. Pikërisht, për këtë arsye ai në disa nga poezitë e tij, më të realizuara artistikisht,këtij problemi i ka kushtuar vëmendje dhe hapësirë të veçantë. Duke e qendërsuar problemin e emigrimit, në poezinë me titull:”Të lutëm më thuaj bir”, poeti me përgjërim iu lutët njerëzve të tij e të popullit të tij,që të mos ikin në mërgim .Lutjet e tij tingëllojnë mjaftë dramatike kur,sikur i drejtohet të birit të tij me këto fjalë:”Të lutëm më thuaj bir/Se nuk do t’i përngjash lejlekut të Mjedës/Nuk do të na lësh vetëm/Si qyqe mali/T’i përqafojmë këto drurë të lagjes/…O si zotin të lutëm/Mos më lërë as mos ik/I trishtuar si lejlekët në mërgim/(fq.74)., … sepse jeta ,në mërgim,sipas

poetit, s'është asgjë tjetër ,vetëm se një mashtrim!Meqë siç dihet migrimi i njerëzve tanë,veçanërisht të rinjëve dhe të rejave tona,tashmë ka marr përmasa dramatike dhe tragjike,përgjërimi i poetit për mos shpërngulje dhe mos emigrim jashtë vendit ,nuk do të këtë edhe aq efekte .sa do të dëshironte ai dhe ne ,të gjithë së bashku. Pra procesi i emigrimit të bijve tanë,për të cilët poeti thekson se po:"fluturojnë /Si zgalemat e dëshpëruar/(si zogj të trishtuar),të pashpresë e të indinjuar, si të ishin zogj të pafat të qyqes. Po largohen e po ikin - si gjethe degësh të shkundura-përtej maleve,luginave,deteve,oqeaneve dhe bjeshkëve të pafund të kësaj bote.(vjersha:"Si zgalemat e dëshpëruar"., fq.78).Duke qenë maksimalisht dhe vazhdimisht i preokupuar,i brengosur dhe i shqetësuar nga kjo gjendje e rëndë,si pasojë e mërgimit,poeti sikur i përgjëron dhe i fton, tashmë të ikurit e shumtë meridianeve të botës së egër të kapitalit e të profitit,që të kthehen në trojet e tyre;në atdheun e tyre,te prindërit e tyre,që vazhdimisht mendojnë për ta dhe sytë i kanë të drejtuar drejtë vend migrimeve të tyre në largësi:"/Sepse kthimi i tyre në atdhe/Do i ringjallë/Edhe gjyshërit e vdekur/"(vj.:"Edhe gjyshërit e vdekur "fq.76.)Më këto fjalë,do të përfundoj poeti ynë shqetësuar dhe indinjuar lidhur me këtë fenomen,që tashmë kaherë është shndërruar, në një plagë dhe vragë gjithëkombëtare që kullon .

Të konsiderueshme janë edhe vargjet ,të cilat i janë kushtuar vetmisë,si një dukuri,gjithnjë e më e shtrirë në kushtet e jetës bashkëkohore, të një demokracie dhe sistemi neoliberal,si gjithandej edhe të ne. Krahas vetmisë,duke e marrë në konsideratë edhe faktorin moshë,autori sikur ndien më shumë peshën e lodhjes dhe të pasigurisë së padurueshme individuale dhe shoqërore:"/Kjo moshë e shtyrë qenka tepër e rendë/Nuk mund të bartët/Zvarritët si mali l lodhur…/frynë në zgërbonjën e shpirtit/…/Përpos hapave të lodhur dhe vetmisë/Askush pranë nesh/Ecim si dy kukëza të drunjta/Pa shpresë…/Qenka shumë rendë/Tepër e rendë kjo peshë e padurueshme /Rendojnë mbi supe ditët/Muajt dhe vitet/Kjo barrë e madhe sa bota/S'durohet dot/Ama as nuk mund ta heqim."/(Si devetë e shkretëtirës".,fq.47. Duke e krahasuar deri në personifikim, gjendjen e tij të vetmisë,moshës dhe çdo gjë që ato sjellin për rrjedhojë,poeti në një masë a një tjetër,sikur e pranon që ndihet paksa i vetmuar dhe i shfuqizuar,deri në përmasën dhe gjendjen e një lisi të dehidruar ,pranë të cilit,sikur nuk gjendet as nuk sillet askush. Në këtë gjendje kuazianabioze,poeti sikur kërkon mirëkuptimin, mbështetjen dhe dorën e ndihmës,për të dalë nga një:" boshllëk i pafund mjerimi".Duke mos pasur as më të voglën përmasë të përkrahjes dhe as ,siç thotë ai vetë :"ledhatimit" të nevojshëm njerëzor dhe shoqëror-kolektiv,lutet sërish për nxjerrje nga boshllëku i imagjinuar,për të

mos mbetur:” si një kallkan i ngrirë dimri”.(str. e fundit e poezisë :”Paskam mbetur”.në fq.84.,të librit. Pra, e gjithë ajo që u tha më sipër,sikur ngërthen në vetë një shprehje e revoltës së poetit, ndaj gjendjes së krijuar dhe ndjenjës së abandonimit nga të tjerët (të afërmit dhe shteti-shoqëria apo edhe më saktë:shprehje e pakënaqësisë me mungesën e përmbajtjeve, prestacioneve dhe shërbimeve më humane të jetës shoqërore); faktor me ndikim këta të cilët do të duhej të ishin,gjithnjë pranë e pranë me njerëzit-anëtarë legjitim të shoqërisë,veçmas më të moshuarit ,të vetmuarit dhe ata që nuk kanë përkrahje materiale-financiare shoqërore.

Mirëpo,në pamundësi për ta ndryshuar cilësisht gjendjen e krijuar shoqërore; meqë nuk bën ndryshe,poeti i vetëdishëm për çdo gjë që ndodhë dhe sillet rreth tij,e kupton se kështu duhet vazhduar:”deri në fund të tregimit”(fq.27. vargu i fundit);madje më fuqi maksimale shpirtërore dhe intrasigjëncë të një personaliteti të pathyeshëm gjatë një kalvari të tërë dhe furtunash jetësore,në mënyrë rezolutive dhe të patundur,sikur i drejtohet një autoriteti imagjinar të hyjnizuar,që në asnjë rast;më asnjë mjet dhe mënyrë ,**të mos ia ngacmojë vetminë e poetit(vargu i fundit i strofës së parë të poezisë: ”Ti asnjëherë nuk erdhe”., fq.88).**

Kjo në vija të trasha është përmbajtja e librit :**”Me natë vijnë lejlekët”** e autorit Adem Zaplluzha i cili

me një fuqi krijuese të jashtëzakonshme,na ka sjell para nesh një vepër,sa të veçantë, aq edhe të pasur dhe do të thosha me primesa të caktuara enciklopedike,që më thotë mendja se do të pritet mirë nga lexuesi dhe do të jetojë gjatë në memorjen tonë kolektive artistike dhe kombëtare.

Libri në trajtim,pa dyshim që i ka edhe anët e veta dispozitive, që do të duhej përmirësuar dhe eleminiuar. Kjo do të duhej bërë, para se po ky libër të dërgohet për botim. E para çështje që do të duhej përmirësuar është organizimi më adekuat i cikleve dhe poezive brenda tyre. Çështja tjetër ka të bëj me nevojën e përputhjes konkordante të titujve me brumin përmbajtësor të materjes poetike, brenda poezive përkatëse. Pra titujt mbase do të duhej të jenë, më domethënës dhe më simbolik;në raport me tërësinë e teksitit poetik përkatës në përmbledhje. Kohezioni poetik,pra tërësishmëria përmbajtësore e materjës poetike në një numër të caktuar të poezive,do të duhej ,mbase të ishte më kompakte dhe më konvergjente me porosinë që pretendohet të jepet nga autori. Gabimet semantike dhe ca të tjera teknike,do të duhej eliminuar paraprakisht.

Të gjitha këto vërejtje dhe sugjerime,në asnjë masë, vëllimin në asnjë mënyrë, nuk ia zvogëlojnë vlerën dhe rëndësinë e kësaj vepre të autorit Adem Zaplluzha.

.

Askush nuk fle sonte
Cikli i parë

MË LËRË TË VDES

Të lutem
Më lërë të vdes sonte
Nuk dua vdekje më të bukur
Se sa kjo kënaqësi
Që shtrihet në krahun e djathtë
Të fluturës së atdheut tim

Dje isha një tjetër specie
Që i ngjasoja erës
Në sqepin tim të çarë
Buronte lumi i verdh
Po ai lumë
Që buron në kujtesë

Sërish të lutem
Si asnjëherë më parë
Më lërë të vdes
Si zogu i ngrirë në mermerë

O të përgjëroj
Me zjarrin e shpirtit të kallur
Më lërë të vdes
Të thash
Nuk dua vdekje më të bukur
Se sa kjo lindje
Që i përket atdheut

KUR EGËRSISHT PUTHIM

Asnjëherë pa u ndalur
Kalojmë nën harqet e Urës së Gurit
Prej një ane të kujtesës
Deri te ana tjetër e hapave tona
Ne ecim si drurët

Në disa raste u përngjajmë gurëve
E në disa raste të tjera
Kur dalim nga lëkura e jonë
Nuk i përngjajmë as jetës
E as vetvetes

Udhët i masim me lotin e erës
Kur dita e jonë epike
I përngjan fantazmagorisë
Deri në ekzaltim
Dehemi nga kënaqësia

Sa herë që na teket pa asnjë arsye
Në secilën pikë loti
I përmbysim detet më të tërbuara
Dhe jemi aq larg vetvetes
Sa që fëmijëria e jonë na duket
Se është tërësisht e huaj

Kur egërsisht puthim
Trishtimin e jetës në ikje e sipër
Në gjumin tonë të përdalë
Si akaciet mbijnë
Disa lloje të barojave
Që sapo takohen me ajrin
Shndërrohen
Në larva të krimbave

DUART E TUA

Duart e tua të mjegullta
Më mbajnë gjallë
Sa herë që kam mall për ty
Shtrihem mbi ëndrrën time

Vetëm kështu jetoj
Mbase kjo qenka e vetmja mënyrë
Ku mund të vdes lirisht
Pa kurrfarë hezitimi

Duart e tua prej shiut të trëndafiltë
M'i ledhatojnë iluzionet
Kur më ndjekin dhembjet
Ndjej thirrjen epike të dashurisë

Duart e tua
Ah ato duar që m'i mbajnë gjallë plagët
Sa herë që i drejtoj sytë kah universi
Shikimi im depërton përtej çdo honi

DHE ATA TË TJERËT

Sonte do të ecim përtej çdo mundësie
Edhe nëse nën hapat e erës
Fshihen shpirtrat e akrepave
Ne do të ecim
Nëpër tehun e mprehtë
Të shpatës së gjetur
Do ecim nëpër llavën e vullkanit të
përskuqur

Kur të mbërrimë deri te mermeri i kuq
Mes kolonadave të erës
Do i takojmë mbretërit
E të gjitha kohërave
Ata që abdikuan
Për disa shkaqe personale
Dhe ata të tjerët
Që i gjykuan dashnoret për tradhti

Por domosdo duhet të ecim
Nëse ndalemi
Kurrë më
Nuk do të jemi në gjendje
Të njëjtë si para
Ose pas lindjes së diellit
Përgjumja askujt nuk i bënë mirë

Sa herë që fjetëm
Nuk i patëm punët mirë
Gjumi i jonë i përdalë
Hynte nëpër çdo udhë të verbët
Hynte nëpër ato vende
Ku nuk mund të delte asnjëherë
I ngjante rërës së gjallë
Në shkretëtirën e shpirtit kryengritës

MBI SHPATULLAT E RRAPEVE

Atë çast hyjnor
Mbeta pa asnjë fjalë
U stepa para mjegullave
Kur ninëza
E lirikave të erës
Si një mbretëreshë prej uji
Hyri në shpirtin e malit

Lëvizën drurët si gurtë
As gjethet më
Nuk ishin në gjendje
Të heshtin
Nga korijet e lulëzuara
Vinte një fëshfërimë prej ëndrre
Ishte koha
E zgjimit të baladave

Nëpër degët e pemëve
Lulet çelnin
Disa specie zogjsh
Çelnin edhe duart e lisave
Disa lloje prej kashelashave
Mbi shpatullat e rrapeve
Era i krihte
Flokët e brymta të shirave

KUR TËRBOHEJ ERA

Kur tërbohej era
Duart e mia nuk ishin këtu
Njëri sy më mbeti te shkurret
Kurse tjetri
Kishte ikur nga rrudhat e ballit

Asnjë pikë shikimi s'kishte mbetur
Në degët e thyera të akacieve
Edhe rrënjët e rrapit të dehidruar
Kishin ikur
Nga Kodra e Trimave

Me lotët e erës
Qyteti i lante duart
Nga majat e gjetheve të lënduara
Pikonte trishtimi

Si në kohërat e liga
Nëpër mëhallën e evgjitëve
Nuk pushonin
Lehjet e pamatura të lukunive

Çdo gjë i përngjante trishtimit
Edhe njerëzit e vegjël
Ishin të frikësuar
Si pëllumbat prej argjile

Nëpër qiellin e plagosur
Të Lumëbardhit
Fluturonin deri në asgjësim
Zogjtë e shenjt të një nate

TË GJITHË KËTU

Fëmijët e fqinjëve të mi
Fshihen nën rropullitë e jorganit
Për çdo natje
I dëgjojmë si në ndonjë kor mbretëror
Piskamat e mëngjeseve

Dënesin edhe çatitë
Ullukët e ndryshkur pikojnë dhembje
Që menatë
Këtu në këtë lagje
Nënat ziejnë gur të murrmë
Dhe trungje drurësh

Kur kemi restrikcione të ujit
Askush nuk merakoset për këtë skamje
Ka aq shumë lot në këtë lagje
Sa që mund ta ziejmë
Edhe hekurin e përskuqur

Por për çudi
Asnjeri nuk ndjen uri
Të gjithë këtu
U përngjajnë përmendoreve
Për të mos dënesur asnjëherë
Prej kalimtarëve huazojnë qeshjet e bronzta

Prishtinë,16 nëntor 2013

VETËM SHATËRVANI I VJETËR

Kur kthehem në qytetin tim
Në katet e sipërme të mendjes
I shikoj ballkonet e zbrazëta
Pa asnjë njeri për t'i pritur
Ose përcjellë lejlekët
E vjeshtës së vonuar

Paskan ikur
Ose janë moshuar të njohurit
Dhe të panjohurit
E qytetit të zambakëve

Shoh fytyra të zbehta në ëndrrat
E të tjerëve
Disa njerëz largohen
Përtej përtejmes
Dhe me nga një trastë të dhirtë
Bartin atdheun nëpër ishujt e harresës

Një lejlek i zi që menatë
Rri mbi një çati të vjetër
Rri dhe shikon
Ndoshta për herë të fundit
Përjeton
Ekzaltimin e lindjes e diellit

2.

Nga grykat rebele të maleve
Kthehen barinjtë
Kthehen edhe bareshat
Me nga një kërthi në prehër
Ose me ndonjë xhemper të thurur
Për dimrat e gjatë të këtyre anëve

Kur vijnë netët nëpër oda zbrazen
Dhe mbushen gjymat
Me verën e një stine të begat
Por ballkonet janë të zbrazëta
Zbrazëtia e cila i përngjan honit
Ose shpirtit endacak të mërgimtarit

Kot trokas nëpër xhamat e erës
Çdo gjë në qytetin tim
Fle në një gjendje asnjanëse

Askënd nuk e njoh
Askush nuk më njeh sonte
Vetëm shatërvani i vjetër
Pikon në xhamat e shpirtit
Duke i përcjellë dhe pretë kalimtarët
Me sytë e qenit besnik
Të Uliksit endacak

SI TË ÇMENDUR TROKASIM

Kur kemi
Ose fare nuk kemi kohë
Ne udhëtojmë nëpër hapësirë
Si zogjtë e egër
prej një ane të rrugës
Kalojmë befasisht
Në anën tjetër të mendimeve
Të shthurura të mjegullave

Ose heshtim
Si guri i murrmë
Ngjan që
Nga duart e padukshme të erës
Kafshojmë mollën e papjekur
Dhe nuk jemi në gjendje
Të kuptojmë
Se si mpihen dhëmbët e portave

Kur bie shiu imcak
Ne deshëm ose jo
I dëgjojmë me andje
Këngët e Nexhmije Pagarushës
Dëgjojmë në kujtesë
Se si fërshëllejnë gjethet
Psalmet e një kohe të humbur

2.

Thash se
Kur kemi kohë
Ne nuk i përkasim askujt
As drurëve qind vjeçar
Jemi vetvetja e jonë
E ikur nga mendja

Trokasim në portat e mëkateve
Si të çmendur trokasim
Edhe te ato të yjeve
Trokasim
Në kotësinë e një kohe të humbur

Prishtinë, 17 nëntor 2013

KUR JANË TË URITUR FËMIJËT

Kur ecin njerëzit
Si për mahi
U përngjajnë drurëve të verbër

Nga degët e akacies
Pikon një lloj qumështi
Me shije të gështenjës

Kur janë të uritur fëmijët
Me afsh të padëgjuar
Thithin nga lëvorja e ahut
Eliksirin e shtrydhur të gjetheve

Nëse qajnë vaji i tyre
Nuk do të thotë asgjë
Përpos shtrydhjes së trishtimeve

Një kafshatë më shumë
Ose më pak
Ku fshihet uria pas një alegorie
Që përjeton e nesërmja e kontaminuar
I përngjan një hiçi në degët e erës

Dhe sërish njerëzit ecin
Ecin deri te ëndrra e tejpërtejmes
Pa kurrfarë problemi
Hynë si buklat nëpër fushat
E pakorrura të pikëpyetjeve

Hynë dhe mbjellin
Një lloj druri të zi
Që rritet
Vetëm në sqepin e lejlekut të bardhë

NJË NJERI MBASE I URITUR

Dje ishte një ditë jo e zakontë
Era dhe shiu trokitnin në xhamat
E thyera të degëve
Një njeri mbase i uritur
Recitonte poemën e mjerimit

Shiu si nga shtambat derdhej
Në thinjat e flokëve të shtjellës
Sërish pash një tjetër njeri
Me duart e shtrira kah qielli
I shurdhët i mesditës
Më duket se
Ai përsëri kishte mbetur pa asnjë lutje

Qante era si një çilimi i braktisur
Dënesnin udhët deri te sinagoga
Edhe një epitaf më tepër
Në këtë trishtim të padëgjuar
Nga fërshëllima e varrtarit
Asnjë trishtil
Nuk ndalet në degët e shimshirit

Nëpër parathënien e muzgut
Kalon një tjetër muzg
Që i përngjan sterrës së frikshme
Ne ecim
Deri te morfologjia e trishtimit
Ecim si një shpresë pa shpresë
Udhëve pa asnjë rrugëdalje

ECJET I KANË TË NGATHËTA

Njerëzit janë si hijet
Ecin përpara herë me sy të hapur
E herë
Me duar të lidhura për koke

Janë të zbrazët pa asnjë ëndërr
Mbase e nesërmja nuk ekziston
Në gjeografinë e mendimeve
Nuk di kujt i përngjajnë
Por janë të boshatisur
Si rropullitë e shpresave

Një ditë bisedojnë me heshtjen e lisit
Kurse ditën tjetër
Nazalet e erës
Bëhen poema të pa kënduara
Dhe qajnë përpara
Deri në një adresë pa numër

Ecjet i kanë të ngathëta
Si shirat e ngadalshëm fundosen
Në përgjumjen e honit
Nëse ndalen në ndonjë bujtinë
Këtë e bëjnë jo për të fjetur
Po për t'i gjetur burimet e ëndrrave

KUR PERËNDON DIELLI I FUNDIT

Kur bezdisem
Pa dashje i thyej gishtat e erës
Prej turtujve huazoj këngën e shiut
Dhe tërë kohën këndoj
Si i çmendur
Serenatën e lëngtë të mallëngjimit

Këndoj të njëjtën këngë
S'ndalem dot as një çast
Disa qindra vjet
Eci nëpër fushat e pentagramit
Derisa kënga ime
I hapi krah më krah portat e shiut
Për një të ardhme që do vij nesër

Kur perëndon dielli i fundit
Zambakët qeshin
Në qytetin e Lumëbardhit
Dhe me muaj të tërë
Nuk ndalen refrenet e pëshpëritjeve

Disa stërkala uji notojnë mbi një gjeth
Vjeshta e verdh i shkund frytet
Nga xhepat e shqyera të stinëve
Derdhen
E nuk pushojnë shirat e kaltra

ASKUSH NUK FLE SONTE

Sonte të gjithë jemi zgjuar
Nuk fle as nata
Druri që ecën kah e nesërmja
I përngjan një cope mishi në trupin tim

Në sqepin e thyer të korbit
Qanë mëngjesi
Rrapet i ka zënë një nostalgji
Sharri plak nuk e ndalë kollën
Kolliten
Edhe gjethet e fishkura nëpër degë

Thash se
Askush nuk fle sonte
Gjumi nuk u bën mirë shokëve të luftës
Te murishtat e shembura
Po sillen vërdallë
Disa mallkime hijesh të zeza

As drurët nuk i zë gjumi
Bisedojnë me miqtë e mi
Sy pishë
Kjo natë e gjatë
Ka vu syrin mbi një gur
Dhe i përgjon
Fluturimet e çafkave të sëmura

DHE NJË NJERI I VETMUAR

Si një lis i dehidruar
Bredhi rrugëve të vetmisë
Askush pranë meje
Përpos bastunit të gjyshit tim

Ecim si dy shkopinj të lënë pas dore
Secili me problemin e vet
Ty të mundon vetmia
Kurse mua diabeti
Është duke mi gërryer rropullitë

Vetëm na mungonte ky shi imcak
I cili çmendurisht troket
Nëpër xhamat e kujtesës
Troket e nuk ndalet qe disa ditë
Gërryen
E gërryen nëpër mendje të erës

Një lis
Një bastun i babagjyshit
Dhe një njeri i vetmuar
Ecin nëpër ëndrrën e shiut imcak
Ecin deri në fund të një tregimi

E CILA PO KAFSHON

Me gishtat e lodhura të erës
I preka të gjitha kujtimet
Dikur vonë i lodhur
E vura kokën
Mbi jastëkun e ëndrrës
Dhe fjeta
Derisa më zgjuan këngët e turtujve

Kur i hapa sytë
Mendova se dimri kishte ikur
Përtej maleve
Dhe asnjëherë nuk kuptova
Se një tjetër dimër më i ashpër
Kishte lëshuar rrënjë në shpirtin tim

Ende edhe sot e kësaj dite
Më duken se gjërat
Nuk ndryshojnë asnjëherë
I përngjajnë
Po asaj ëndrre që e shoh çdo natë
Veshur me një pallto të trishtuar
E cila po kafshon
Egërsisht është duke i shqyer
Këmishët e mia të leckosura

SA JEMI LARG NJËRI - TJETRIT

Të thash
Mos më zgjo nga ëndrra ime
O të lutem mos më zgjo
Qenkan të paprekshme duart e erës
Kjo natë e gjatë
Kurrë të mos soset sonte

Të lutem
Më lërë në këtë gjendje të ngurtë
Dua të vdes
Si flutura në përqafimin e qiriut
Unë dhe ëndrra ime
Sa jemi larg njëri- tjetrit
Në këtë çast të paharruar

Më lërë kështu të lutem
Mos i ngacmo as fluturat
E kësaj kënaqësie
Dua të fle
Si një kërthi i mëkuar
Mbi flatrat e një ëndrre
Po lind një botë e re
Që i përngjan dashurisë

PA TITULL

Unë nuk i frikohem plumbit
As vdekjes
Por të lutem
O të përgjëroj si Hyjin
Mos m'i mbytë shpresat
Në zemrën tënde të brishtë
E dashura grua

Kuajt e mi të bardhë
Cikli i dytë

NJË KËNGË E BARDHË

Po vijnë shirat
Si qengjat
Po kërcejnë stërkalat
Nëpër sqepat e thyera të lejlekëve
Mbinë trëndafilat

Po kthehen mërgimtarët
Nëpër sokakët e qytetit tim
Për çdo ditë
Hapen dhe mbyllen qepenat
Kalldrëmet zgjohen nga kllapia
Zgjohen
Dhe i përshëndesin zogjtë

Plakat e mëhallës
I kanë shqyer shamitë e zeza
Dhe nga kajsishtat e mbjella
Kësaj radhe
Paskan ikur kukuvajkat

Një këngë e bardhë
Si kurdoherë më parë
Dëgjohet mbi pastelet e luleve

Prishtinë, 18 nëntor 2013

TË VARFRIT E QYTETIT TIM

Në qytetin tim
Të varfrit kanë dëshira të vogla
Këta njerëz të mëdhenj
Kënaqen me pak gjëra të imta
Me një kafshatë bajate
Dhe me pak kripë
Si në mahi
E tejkalojnë maratonën e urisë

Ecin si të dehidruar
Prej një treni deri te një autobus tjetër
Duke i shikuar në sy njerëzit e kamur
I njohin ata fare mirë i njohin
Duart që japin lëmoshë

O sa mirë i njohin njerëzit e mirë
Nuk ja zgjasin çdokujt dorën
Ecin dhe qendrojne
Me dinjitet njerëzor

Kur vjen e nesërmja në sytë e tyre shndrin
Një e nesërme tjetër
Dhe nuk merakosen për asgjë
Ndonjëherë i shtrijnë shikimet
tejpërtejmes
Kurrë në shpirtrat e tyre nuk vdes optimizmi

Për këta njerëz të mëdhenj
Nuk ëndërrojnë saga që s'i përqafon mendja
Por në urtësinë e tyre
Prej një lypsari
Ndërtojnë kullat më të bukura të shpresave
Për një të nesërme
Me një buzëqeshje më ndryshe
Më madhështore
Se kjo e sotmja...!

VAZHDON PO AI REFREN

Ka çaste nuk na kthehet në kujtesë
Fëmijëria pa ëndrra
Si një mollë e vetmuar
Dielli i përskuqur
Piqet në imazhet e horizontit

Ecim përskaj trotuareve
Nuk ndalemi në asnjë shitore
Ecim si kukullat në teatrin tragjik
Të përditshmërisë
Pas shpine i lëmë vitrinat e zhveshura

Lumëbardhi gurgullon në përgjumjen
E një dite pa rrugëdalje
Njerëzit kalojnë
Ecin pa e përfillur erën
Mjegulla e dendur na i shprish flokët

Të nesërmen
Vazhdon po ai refren
I përditshmërisë se numërimit të hapave
Dikush troket nëpër dritaret përdhese
E dikush tjetër
Te portat e yjeve të verdha

KUAJT E MI TË MIRË

Mbi një araba prej ëndrre
Udhëtoj nëpër fëmijërinë time
Më del parasysh
Rrugë e gjatë dhe e lashtë
Vrapi i kalit të zi
Pa frena nuk e ndalte trokun
Deri në Kostandinopojë

Më kujtohen imazhet e erës
Kur e ndaja misërniken
Me arabaxhiun babaxhan
Me një copë djathë dhie
Kapërdinim tërë bukën e çerepit

Nëse na premtonte koha
I pushonim kuajt
Në ndonjë han të vetmuar
Ku gjenim hanxhiun duke na pritur
Me pagurin e mbushur
Me verë të kuqe

Më pastaj sërish na prite
Një udhë e gjatë
Derisa arabaja tundej
Në ëndrrën e plepave
Kuajt e mi të mirë
Gjumin e bënin në ecje e sipër
Duke i numëruar
Gurtë e kuq të kalldrëmeve

NUK MARR DOT FRYMË PA TY

Të lutem o të përgjëroj
Mos shko në këtë çast
Me trenin e çmendur të mëngjesit
As me atë të mbrëmjes së vonshme
Nuk marr dot frymë pa ty

Kjo aromë e pemëve që zbret
Nga kujtesa e degëve
Ishte dikur në ëndrrën e flokëve të tua
Të lutem
Mos shko me trenin e çmendur

Jam pakëz i lodhur
Më dridhen këmbët e fishkura
Si purtekët e metaltë më dridhen
As duart më
Nuk i përngjajnë duarve
Kjo ëndërr e sfilitur po dënes si qilimi

Të lutem mos ik sonte
Nëpër shtegun e binarëve të verbët
Ti e di
Se unë tani jam shumë i lodhur
Nuk mundem t'i ndali
As të reshurat e verdha të stinës

DUART E MIA

Duart e mia
Si duart e pemës së egër
Marrin frymë
Qeshin me udhëtarët e vonuar
Qeshin me njerëzit
Që i kanë humbur kujtimet

Qeshin
Dhe i përqeshin zogjtë
Krahthyer
Marrin frymë si gjelbërimi
Nën degët e këputura te shelgjeve
Ndërtojnë kala prej ëndrrave

Duart e mia
Si ato të erës asnjanëse
Nëpër skutat e gjelbërimit
I humbin rrugët

Dhe asnjëherë më shpresat
Nuk kthehen të pinë ujë
Në kroin e kujtimeve
Ku vërshojnë ëndrrat e përrenjve

Duart e mia
Nuk i përngjajnë asgjëje
Sepse çdo lëvizje e tyre
E përqafon pafuqinë
Herë janë si aroma e mushmollës
E herë si kundërmimi i ashtit të thyer
Në ndonjë trup të ndërkryer

SEPSE E NESËRMJA

Më thanë te mjegullat ka varre
Edhe përtej mjegullave
Pohojnë se
Lindin njerëzit me nga një sy
Dhe kur kanë kohë
Dynden si shirat në mesin tonë

Atje është ajo e përtejmja
Që i përngjan fjalëve të shthurura
Të vetëtimave
Ku njerëzit me xhelozi
I rruajnë ëndrrat e vjedhura
I rruajnë
Si vashat e vogla kukullat
E drunjta të erës

Nëse i lajmë duart me ngjyrat blu
Te ylberit
Dhe të reshurave ua marrim zemrën
Mund të takohemi me një tjetër kohë
Sepse e nesërmja
Më nuk do të jetë më nesër
Por një hapësirë krejtësisht tjetër
Mes të kaluarës dhe të ardhmes

SI ÇAFKAT E SËMURA

Nga majat e gishtave pikon dita
Zogjtë e blerimit tim
i kanë harruar çerdhet,
Bredhin hapësirës
Si mjegullat
pa itinerar

Ikin ose vijnë trenat
Nga dritaret e autobusëve
Udhëtarët i gjuajnë letrat e dashurisë
I gjuajnë edhe shikimet e zbrazëta
Në drejtim të vashave sygështenjë

Në një katrahurë mendimesh
Përzihen disa lloje emocionesh
Përzihen si mendimet e lënduara
nga rrebeshi
Jashtë dhomës sime
Si për mëri frynë
Një erë e fortë i shkulë lisat.
e sëmurë

Veriu i acartë frynë
E nuk ndalet në asnjë portë
Mendimet bien në tokë
Si çafkat e sëmura

Shkëputen degët e mushmollës
Pa shënuar dot-kurrë
Asnjë kuotë!
Një dimër i zi po vjen
Arkeologët me lopata të ngrira
Rrëmihin të kaluarën e hidhur të erës
Duke mos lekundur fare portat e humnerës...

ZOGJTË E IKUR TË MENDJES

Në kujtesën time të kositur
Sërish po mbinë bari
Zogjtë e vetmuar të korijeve
Kanë filluar t'u përngjajnë turtujve

Vera iku më herët sivjet
Kurse dimri ka mbetur peng
Mes një kohe asnjanëse
Çfarë të bëjë me duart e mia

Kjo kohë e ngrysur
Paska hyrë në shpirtin e zgërbonjës
Dhe pret që në befasi ta sulmoj ditën
E cila posa është nisur
Në një udhëtim pak më ndryshe

Asgjë më nuk i përngjan etjes
Mëngjesi vuan nga kotësia
Zogjtë e ikur të mendjes
S'fluturojnë më këndej pari

Prishtinë, 19 nëntor 2013

SI DEVETË E SHKRETËTIRËS

Kjo moshë e shtyrë qenka tepër e rënd
Nuk mund të bartet
Zvarritet si mali i lodhur
Më është rënduar mbi supe
Lakohet në dysh kurrizi i thyer
Si te rrapi i bardhë
Frynë erërat në zgërbonjën e shpirtit

Përpos hapave të lodhur dhe vetmisë
Askush pranë nesh
Ecim si dy kukëza të drunjta
Pa shpresë
I shkelim udhët e ndrydhura
Të ditëve
Që vijnë dhe ato që ikin

Qenka shumë e rënd
Tepër e rënd kjo peshë e padurueshme
Rëndojnë mbi supe ditët
Muajt dhe vitet
Kjo barrë e madhe sa bota
S'durohet dot
Ama as nuk mund ta heqim

Si devetë e shkretëtirës
Pushojmë nëpër oazat e kujtesës
Për inatin tonë
S’ndalen buzëqeshjet e drurëve të shtrembër
Qeshin e qeshin me ne zhapikët prej dune
Kurse pesha
Në çdo hap më e rënd se jeta

SHTËPIA IME

Shtëpia ime e ngrohtë
Më pret diku në vetmin time
Askush brenda
Përpos fëmijërisë së hidhur
Dhe sandaleve të motrës

Një palë këpucë të vjetra
Të arnuara nga duart e babait
Ai njeri i mirë
Për çdo festë fetare
Na arnonte këpucët dhe dhimbjet

Shtëpia ima mbuluar me kashtë thekre
Asnjëherë nuk pikoi trishtim
Me duart e saja të ngrohta
Na mbante gjallë
Dhe shpeshherë
Recitonte poemën e mjerimit

Por ishte shtëpia e jonë
E ngrohtë si zemra e nënës
Kur kishim mall
Për diellin e përflakur të atdheut
Krah më krah i hapnim dritaret

PËR TA MBËRRI FUNDIN

Rrugët janë të gjata
E kur të mbërrimë në fund
(I cili asnjëherë
askund nuk ekziston)
Mu aty mbërrijmë
Mund t'i prekim mendimet e erës

Ndoshta njerëzit nuk kuptojnë
Por në fundin e një fundi
Fillon një tjetër fund pambarim
Pa emër
Dhe pa mbiemër
Ku mund të humbim
Si zogjtë e ngrirë të një stine

Ne duhet të ecim, bijtë e mi
Domosdo duhet të ecim
Përtej ngadhënjimit të fjalës
Nëse ndalemi
Te fundi që nuk ekziston
Do filloj sërish një tjetër fund

Në hapin e parë
Të vrapit të kaprollit të verbër
Fillon përmbytja e yjeve
Dhe detet fundosen në univers

Për ta mbërri fundin
Nuk duhet shumë mençuri
Ne edhe ashtu jemi në fund
Andaj duhet të fillojmë të ecim
Nga fillimi i një fundi
Që s’duket askund
Në horizontin e imagjinuar

MOS TË LUTEM MOS THUAJ

Mos të lutem
Mos më thuaj
Se këtu është fundi i rrugës

Ditët posa kanë filluar të lëvizin
Përtej mendimit të shiut
Po lahen në pluhurin e horizontit
Trëndafilat e zinj

Mos thuaj se është stinë vjeshte
Ani se shirat
Lotojnë si detet e pikëlluar
Ti asnjëherë
Nuk do të përmirësohesh

Shih se si po luajnë me ne
Të vdekurit mes të gjallëve
Një valle të lashtë morti

Mos të lutem
Mos thuaj se jemi në fund
Fillimi i ditës
Posa ka nisur të ecën
Po bien do shira të verdha
Mbi flokët e shprishura të hënës

Ishim njëherë
Ose nuk ishim askund
Kur luante Lumëbardhi me fatin e erës

Shiko të lutem
Se sa shumë i xhelozon kalaja
Prekjet e gishtave të tua

Mbi supet
E posa të çelura të zambakëve
Kanë zënë të çelin vezët e kanjushave
Disa lloje të tjera lejlekësh

NGA BARRA E MËKATIT

Kur stërkalat e shiut imcak
Bien me rrebesh
Mbi flokët e mia të thinjura
Nën një gjeth të mykur të fatit
Rrëqethet dreri i verbët

Nën hijet e mjegullave
Ylberet i fshehin ngashërimet
Vashat lahen me lotët e hënës
Trishtimi zbret nga degët e pemëve
Dhe qan me ngashërim
Si një mjellmë e plagosur

Kur shurdhohet zëri i kambanës
Të vetmuarit
I humbin edhe shpresat e fundit
Nga barra e mëkatit
Degët e mushmollës së pikëlluar
Lëshohen
Deri në fund të rrënjëve

BARRA QË MUND TA MBAJ SONTE

Vrapoj si shiu i përhumbur
Nëpër rrugët e brymta të qytetit tim
Një zë më vjen nga lashtësia
Mbase është zëri i kujtesës

E shiu troket si i çmendur
Nuk ndalen të trokiturat në mendje
Shtreza ka filluar të ecën si drurët
Ecin çatitë
Nëpër shpirtin e ngurtë të hënës

Asnjë kalimtar nuk duket në horizont
Vetëm kjo vetmi e brishtë
I shtrinë duart
I shtrinë kah pikëllimi i plepave
Ku qajnë zogjtë e verbër të fëmijërisë

Më duket se
Sonte është për çdo gjë vonë
Tepër vonë që të pendohem sërish
Ky faj që më rëndon në shpirt
Mbase qenka barra më e lehtë
Që mund ta mbaj sonte

CILI DO QOFSH TI

Ndalu
Ndalu të lutem
Cili do çofsh ti që shkelë sonte
Nëpër ëndrrën time
Ndalu
Se përndryshe do i shembësh
Të gjitha urat

Kur ishim të rinj
I preknim flokët e mëndafshta yjeve
Po ashtu
I ngacmonim
Edhe vashat sygështenjë
Deri në mëngjes bisedonim
Me gjethet e verdha

Ndalu miku im
Cili do qofsh ti
Ndalu sonte
Më trego se kush je
Që kaq shumë i përngjan kryeneçësisë

SI NJË MALLKIM I HERSHËM

Nëpër trotuare të pa meremetuar
Si shtëllunga prej mjegulle
Kalojnë njerëzit e dëshpëruar
Secili kalimtar ecën
Me mendime të shthurura

Një njeri i moshuar
Të cilin e takoj çdo ditë
Kalon pran meje
Si një hije e paprekshme
Si një mallkim i hershëm
Një trastë e vjetër i varret pas shpine

Ecën ky njeri me brengën e viteve
Ecin edhe të tjerët pas tij
Secili më i dëshpëruar se tjetri
U përngjajnë semaforëve
Që kyçen e shkyçen

Nëpër këto trotuare ecin shiringat
Ngjizur me një pluhur të bardhë
Parakalojnë devetë e verbuara
Njerëzit u përngjajnë
Kukullave të drunjta
Ecin si hijet e zeza në procesion

Prishtinë, 20 nëntor 2013

KUR NUK VJEN TI

Kur nuk vjen ti
Nata është e gjatë aq e gjatë
Sa që pashmangshëm i përngjan
Atyre netëve të thikave
Kur çaheshin drurët nga dhembja

Lëvizin damarët
Tmerrshëm lëvizë frymëmarrja
Nga degët e vetmuara të yjeve
Shkunden gjethet e mbrëmjes

Një gjysmë hëne noton diku për në askund
Por nuk ndalet si ora e vjetër në stacion
Noton nëpër mjegullat e çmendura
Si trenat e verbër
Ecën nëpër shpirtin e thyer të reve

Dikur vonë kur mbërrin trenat në stacion
Shoh se ti nuk je në mes të njerëzve
Dhe valixheve të drunjta

Pas mesnate kur udhëtarët
Shpërndahen të vetmuar
Secili shikon punën e vet
Përpos meje dhe pritjes
Askush s'merr frymë pranë binarëve

SIVJET PËR HERË TË PARË

Po bien
S'pushojnë shkundjet e gjetheve
Si perënditë e përrallave
Po vdesin fluturat e bardha
Një ylber te kujtesa
Thurë xhemperin e një stine të vrarë

Sivjet për herë të parë
Kaluan zbathur këndej pari dimrat
Kaluan edhe acaret
Ngarkuar me trishtim
Një zog i vetmuar
Mbi një çati të stinës
I përcillte për në atdhe lejlekët e vonuar

Po bien
Nëpër sheshet e qyteteve
Po bien përmendoret
Një kohë e bronztë shkrihet në hapësirë
Nga shpirtrat e kolonadave
Si nëpër tregime të lashta
Ringjallen perëndit e vdekur

ME PLAGË TË PASHËRUARA

O kush jeni ju të më mësoni
Se si duken prangat
Dyzet e katër vjet jetova i prangosur
Si luani në kafaz
Dhe akoma kam mbetur
Me plagë të pashëruara

Nuk më besoni por lindja ime
Ishte një trishtim i paharruar
Nën rrogozin e vuajtjes
Dhembja lëshonte gjëmën e përditshmërisë
Dhe ju sot më tregoni
Se si duhet me e dashtë atdheun

O kush jeni ju të më mësoni
Se atdheu është një peng
Që të mban
Dhe nuk të lëshon asnjëherë
Mbi katër dekada e barta gurin e pikëllimit
Dhe gjumin kurrë nuk e pata gjumë
Me sy të mbyllur e ëndërroja lirinë

O kush ishit ju që nga faqet e abetares
Deshët të mi zbritni germat
Dhe si lugetërit e zinj
Ma kafshuat palcën deri në asht

Unë asgjë nuk desha
Më shumë se ju në jetën time
Desha vetëm të jem një njeri i lirë
Në atdheun tim të robëruar

KUR ISHIM TË RINJ

Kur u plakëm
Bisedat i patëm të gjata
Por as bastunët nuk na dëgjonin
Kishim harruar
Se si shkruhen letrat e dashurisë

Na ikën kohërat
Nuk na njeh as amalgama e pasqyrës
Si ajri i pastër i dimrit të kristaltë
Jemi të tejdukshëm
Nëpër trupin dhe shpirtin tonë
Si hijet hynë dhe dalin njerëzit

Tani më të njohurit tanë kanë ndryshuar
Janë pakëz më të çuditshëm
Se sa çfarë ishim ne
U përngjajnë kukullave të dyllta
Nëpër vitrinat e pista të shpirtit

Kur ishim të rinj
Aq pak probleme kishim
Sa që u përngjanim fluturave të egra
Depërtonim nëpër shpirtin e çdo flake
Që kallej si malli i nuses
Në zemrën e brishtë të shpresës

NJË DITË

Një ditë ndoshta që nesër
Ne do gjejmë një vend
Ndoshta do jetë prehri i ndonjë druri
Ku mund t'i mbështesim
Kokat tona

Jemi lodhur
Aq shumë jemi të lodhur
Sa që shpirti i jonë delikat
Po bëhet copë e grimë
Në lotin e kristaltë të erës

Një ditë ndoshta që nesër
Do kthehemi në baltë
Nga e cila erdhëm

Jemi sfilitur
Dhe mbetur pa miq
S'kemi me kënd të luajmë
Një lojë shahu
Më kujtohet
Kur për mbretëreshën
I flijonim kuajt dhe oficerët

Një ditë në përrallat e gjetheve
Ne do të gjejmë një vend
Ku mund të pushojnë
Shpirtrat delikat të njerëzve
Dhe pemëve që ecin vertikalisht

Prishtinë, 21 nëntor 2013

Menatë vijnë lejlekët
Cikli i tretë

MENATË VIJNË LEJLEKËT

Po kthehen lejlekët
Po kthehen tok me baladën e një stine
Në shpirtin tim të acartë
Po mbinë luleborat

Për çdo menatë
Një zog i vetmuar
Rri në çatinë e kujtesës
Rri dhe i numëron ardhjet e brishta
Si dhe shkuarjet
E lejlekëve përtej deteve

Po ashtu edhe njerëzit
Si kanjushat e verdha
I presin letrat e mërgimtarëve
I presin me padurim
Mos vallë fëmijët tanë
Po shndërrohen
Në zarfe të kaltra trishtimi

Po kthehen
Menatë vijnë lejlekët e vetmuar
Me një grusht trishtimi
Ku presin që në atdhe të kenë një vend
Ku mund ta mbështesin
Te ndonjë zgërbonjë kokën e lodhur

KTHEHEN DHE SHKOJNË SËRISH

Sa herë që shkurtohen ditët
Në qyteti tim vijnë lejlekët prej letre
Fëmijët dalin rrugëve
Vrapojnë si drerët e egër
Vrapojnë e nuk ndalen në asnjë stacion

Përtej hapësirës së paanë
Shikojnë qiellin e ngrysur të vendlindjes
I shikojnë dyndjet e zogjve shtegtar
Dhe me lot mjellme
Si lumi dënesin me ngashërim

Vijnë dhe kthehen
Kthehen dhe shkojnë sërish
Zogjtë e verdhë prej letre
Një mall si një zjarr i pashuar
Herë ngre kokë
E herë bie në dy gjunjë
Mbi shpirtin e shkallmuar të pritjes

KUR ISHIM TË VEGJËL

Kur ishim fëmijë
Ah kur ishim të vegjël
Më së miri kuptonim atëherë
Se sa ishin të lumtura rrugët
Nën hapat tona të brishta

Dinim të shkruajmë letra dashurie
Gjenim fjalë të bëra prej ere
Ose i shkulnim germat
Nga dunat e rërës nëpër sytë e mjegullave
Por shkruanim letra
Nëpër zarfe të kaltra si qielli i Kosovës

Kurse sot ecim të zbrazët
Jemi të tërë bosh
Kemi mbetur pa fjalë
Mbase kryefjala e fjalëve tona
Qenka tretur diku me fëmijërinë

Ecim të mërrolur rrugëve
As të dashurat tona
Më nuk janë ato vasha të vogla
Që gëzoheshim me një karamele
Kanë ndryshuar shumë
U përngjajnë
Dëshirave të tyre të çmendura

UNË KAM HARRUAR KUR ISHA FËMIJË

Shpeshherë u them nipërve të mi
Se unë kurrë nuk isha fëmijë
Më rriti varfëria
Më rriti aq shumë
Sa që para kohe u burrërova

Në moshën time të njomë
I përngjaja lejlekëve të verdhë
Tërë ditën me një drapër të vjetër
Kositja barin e gjelbër të luadheve

Për një gllënjkë qumësht
Kam mbledhur gjethe akaciesh
Ditët e mia ishin të ngarkuara
Vetëm me dhembje
Unë kam harruar kur isha fëmijë

Ose asnjëherë nuk isha i vogël
Më rriti skamja
Armiku më mësoi se si dhe sa duhet
Me e dashtë atdheun
Ja pra pinjollët e mi të mirë
Gjyshi i juaj
Kurrë nuk ishte fëmijë

TË LUTEM MË THUAJ BIR

Të lutem më thuaj bir
Se nuk do t'i përngjash lejlekut të Mjedës
Nuk do të na lësh vetëm
Si qyqe mali
T'i përqafojmë këto drurë të lagjes

Kjo sterrë e tunxhtë
Si balsam i dendur pikon në shpirtin tim
Të lutem
O si Zotin të lutem
Mos më lërë as mos ik
I trishtuar si lejlekët në mërgim

Të kujtohet Bardhyli i Bardhit
Letrat e të cilit
I lexoje me ngashërim
Ai më nuk mund të na shkruaj
Nga arkivoli
S'do kthehet asnjëherë
Sepse jeta e tij në mërgim
Ishte vetëm një mashtrim

Të lutem më thuaj bir
Se kurrë më
Nuk do t'i përngjash zogjve shtegtarë
Shih se si kemi mbetur me nënën
Si një trishtim i paparë

EDHE GJYSHËRIT E VDEKUR

Nëse nuk kanë se ku të flenë
Zogjtë e ikur
Do i ftojmë të flenë me ne
Mbi drurët e ngrirë të atdheut

Dimrat këtu fshihen pas mjegullave
Dhe nuk janë aq të acarta
Në çdo kohë
Presin ardhjen e pranverës
Dhe kthimin e lejlekëve të penduar

Një ditë po që se zbresin malet
Si lumenjtë
Do dalim shëtitoreve t'i presim kanjushat
Sepse kthimi i tyre në atdhe
Do i ringjallë
Edhe gjyshërit e vdekur

LEJLEKU

Atë ditë pat vetëm një ëndërr
Kur u largua lejleku im
Kurse të nesërmen
Jeta e tij
U shndërrua në një trishtim

SI ZGALEMAT E DËSHPËRUAR

Fluturojnë
Si zgalemat i dëshpëruar
Po rrëshqasin ditët mjegullave
Tej maleve të pafund
Po largohen zogjtë e trishtuar

Orët bëhen vite
E vitet shekuj prej maktheve
Zogjtë e pafat të qyqes
Si gjethet
Po shkunden nga degët e ngrira

Mos ndodhtë më kjo dhembje
Një kanjushë e vetmuar
Dënes mbi një dunë lotësh
Po ikin edhe turtujt e dëshpëruar
Të fatit
Po ikin zogjtë e pashpresë

NJË ZË I VEÇANTË SI PËRHERË

Kur i shikonim kanjushat
Nga krahët e plagosura
Pikonte trishtimi
Një zë i veçantë si përherë
Buron nga zgërbonja e shpirtit

Po vijnë ose po shkojnë retë
Shpërndahen mjegullat
Një ditë e zymtë mbi flatra dhembjesh
I përngjan
Zvarranikëve parahistorik

Pas shpine më vjen një zë
Më duket se
Është po ai zë që vjen nga thellësia
Zëri i trishtuar i kujtesës
Dëgjohet si hukamë deti
Duke u përmbytur mes shkëmbinjve

Vetëm një meduzë e vetmuar
Mbi një kresht të dendur uji
Me duart e plagosura të erës
Ia mbyllë të gjitha portat
E shpirtit gllabërues të shkumës

Prishtinë, 22 nëntor 2013

ATJE KU PËRFUNDOJNË FJALËT

Një pikturë e pikëlluar
Rri mbi maje të një plepit
Të metaltë
Era frynë nëpër zgërbonjën e shpirtit
Një copë e shqyer prej mjegulle
U bënë hije lejlekëve të dylltë

Nga një çerdhe e vetmuar
Bien në tokë ca vezë të bronztë
Tejpërtejmes së paanë
Nuk ndalen fluturimet e zogjve

Meteorët e verbër
Si nëpër përralla ngarendin
Skutave të harruara të shpirtit
Lotët e nuseve të reja
Pikojnë së rrëshira
Mbi flokët e trishtuara të ditës

Kolona ecën në heshtje mortore
Atje ku përfundojnë fjalët
Ngre kokë kryefjala
Disa hije të njoma te murishtat
Ka kohë
Që bisedojnë me arkivolet e mykura

LATONTE TRISHTIMIN E NJË KOHE

Në rrugëtimin tim të gjatë
Mbi çdo çati dhe plep
Kah do që fluturova
Lash nga një pjesë të jetës

Kur hyra nën urën e legjendës
Së Rozafës
Pashë se si nga qumështi
I gjirit të ngurtë të historisë
Ringjalleshin njerëzit
Dhe qemerët prej guri të ftohtë

Një usta i hijeve të strallta
Latonte trishtimin e një kohe
Latonte me mall të pashuar
Shpirtin e një druri të murrmë

E muranat shikonin me nostalgji
Se si përdridhej era
Në harkun e lakuar të kohës
Dhe parakalimin e vashave
Me gjinj prej silikoni

MË FAL NËNA IME

Sa shumë po i përngjan ky lejlek
Ëndrrës sime prej sfinksi
Për çdo menatë
Me krahët e bardha të erës
I mbështjell si nëna foshnjën
Plagët e një dune të përlotur

Më fal nëna ime
Më fal
Edhe burrat qajnë
Qajnë
Më shumë se gurtë e atdheut
Çdo lot i ngrohtë njeriu
Në vete paska një trishtim

Më fal nëna ime
Më fal për herë të njëqind
Por nuk mund të duroj
Nuk më ka mbetur asnjë pikë durimi
Mbase edhe unë po u përngjaj
Këtyre gurëve
Që asnjëherë nuk i ndalin vajet

Më trembin
Si enigmat e trishtuara
Me trembin këto hije
Që zvarriten shpirtrave të ngrirë
Kjo natë e stërgjatë
Paska ngecur diku mes baladave

PASKAM MBETUR

O ju përgjëroj njerëz
Më nxirrni
Nga ky boshllëk i pafund
Duart dhe shpirti im
Po fundosen
Pashmangshëm po fundosen në mjerim

Kam mbetur si kallkanët
Mes këtyre netëve
të gjata të dimrit
Asnjë ledhatim të ngrohtë dore
Nuk ndjen lëkura ime

Si të dal nga kjo zbrazëtirë
E pashpirt
O ju lutem
M'i zgjatni duart e mishta

Nga vetullat e mia të thinjura
Pikojnë si lotët
Shtreza të ngrira prej dhembjeve

Kah më qon kjo udhë
E kah ajo tjetra
Kam mbetur si kërcu
Mes kësaj shkretëtire të urisë
Paskam mbetur
Si një kallkan i ngrirë dimri

NËPËR TË CILIN VEND

Nëno kjo kanjushë
Paska një tatuazh të verdhë në sy
Nëpër të cilin vend
Kaluan lukunitë e ujqve
Duke i shkretuar kullosat e bletëve

O ju lutem më tregoni
Pse ikën mbrëmë mjellmat e bardha
Ne nuk kishim ndërmend
T'i zëmë zogjtë
Moti e kemi lënë fëmijërinë prapa shpine

Te çezma e plakave një lejlek i vetmuar
Piu ujë
Dhe iku përtej mjegullave
Zogjtë që erdhën nga mërgimi
Kishin nga një plagë në shpirt

Ky shi sonte paska një tjetër trajtë
Nga sqepi i plagosur i lejlekut
Pikon dhembja e ditës
Kush i vrau zogjtë te një stinë
Kur dëneste
Me ngashërim qielli im i vjedhur

ME GJASA NJË KORB I ZI

Në fluturimin e parë
Një zog kaloi nëpër ëndrrën e mishtë
Të erës
Aroma e mishit të pjekur
Kishte marr me vete të gjitha fushat

Me gjasa një korb i zi
Kishte mbetur te përrenjtë
Kishte mbetur dhe ëndërronte
Një fluturim salto mortare
Deri në rrënjën e rrapit kryeneç

Një shungullimë gjethesh zbrite
Nga Lugu i Zanave
Nëpër qiellin katran një fluturim i paparë
Dolën nga nëntoka
Kalorësit e bardhë të rrufeve

TI ASNJËHERË NUK ERDHE

Mund të mos kthehesh sonte
I kam mbyllur të gjitha shtigjet
E fluturimeve
Më lërë të lutem
Mos e ngacmo vetminë time

Nuk është hera e parë
Që po përsëritet kjo uverturë
Edhe herëve të tjera
Kam pritur një fluturim lejlekësh
Nuk di se sa mëngjese kanë gdhi
Në pasqyrën e akullt të kujtesës

Ti asnjëherë nuk erdhe
As nuk ma mësove
Mjeshtrin e fluturimit
Kjo natë qenka tepër e gjatë
Kur i shtri duart kah kotësia

Të thash më
Nuk ke nevojë të kthehesh
Në çerdhen tënde çelën zogj të tjerë
Edhe ashtu mjegullat
Më kanë zbërthyer
Në qindra cifla gurësh

U bëra një pjesë e pandashme
E kësaj xhadeje
Duke pritur
Të lulëzojnë ftonjtë e ngrirë të fluturimeve

Prishtinë, 23 nëntor 2013

SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990*, nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në

librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar "Fahri Fazliu", në Kastriot.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010

32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12

48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012

64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Përfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013

80**. "Refrene yjesh",** Poezi, Shtëpia botuese "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2013
81. **"Te delta e mjellmave",** Poezi, Shtëpia botuese "Fahri Fazliu", Kastriot- 2013
82.**"Rinjohja",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2013
83**."Diku në fund të një fillimi",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2013
84**."Makthi i hijes",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-" Fahri Fazliu"Kastriot, 2013
85.**"Një zog prej uji",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"- Kastriot
86**."Asnjë fjalë nuk frymon",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu" Kastriot, 2013
87**."Daullet e një nate",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot ,2013
88**."Sytë e gurtë të erës"**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot, 2013
89."Kur dehen perënditë" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot ,2013
90. **"Fjetëm njëqind shekuj"**Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot , 2013
91.**"Krakëllimat e natës",**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot, 2013
92**. "Ndjekësit e enigmave",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot ,2013
93. **"Atdheu i paçmuar"**Poezi, Shoqata e " Fahri Fazliu"s Kastriot, 2013

94.**”Psalm i harruar ”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2013
95,”**Për kë po bie moj kambanë”,** Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2013
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2013
97. **“Menatë vijnë lejlekë**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2013

PËRMBAJTJA

Askush nuk fle sonte - Cikli i parë 19
Më lërë të vdes 21
Kur egërsisht puthim 22
Duart e tua 24
Dhe ata të tjerët 25
Mbi shpatullat e rrapeve 27
Kur tërbohej era 28
Të gjithë këtu 30
Vetëm shatërvani i vjetër 31
2. 32
Si të çmendur trokasin 33
2. 34
Kur janë të uritur fëmijët 35
Një njeri mbase i uritur 37
Ecjet i kanë të ngathëta 39
Kur perëndon dielli i fundit 40
Askush nuk fle sonte 41
Dhe një njeri i vetmuar 42
E cila po kafshon 43
Sa jemi larg njëri tjetrit 44
Pa titull 45
Kuajt e mi të bardhë - Cikli i dytë 47
Një këngë e bardhë 49
Të varfrit e qytetit tim 50
Vazhdon po ai refren 52

Kuajt e mi të bardh 53
Nuk marr dot frymë pa ty 55
Duart e mia 56
Sepse e nesërmja 58
Si çafkat e sëmura 59
Zogjtë e ikur të mendjes 61
Si devetë e shkretëtirës 62
Shtëpia ime 64
Për ta mbërri fundin 65
Mos të lutem mos thuaj 67
Nga barra e mëkatit 69
Barra që mund ta mbaj sonte 70
Cili do qofsh ti 71
Si një mallkim i hershëm 72
Kur nuk vjen ti 73
Sivjet për herë të parë 74
Me plagë të pashëruara 75
Kur ishim të rinj 77
Një ditë 78
Menatë vijnë lejlekët - cikli i tretë 81
Menatë vijnë lejlekët 81
Kthehen dhe shkojnë sërish 83
Kur ishim të vegjël 84
Unë kam harruar kur ishim fëmijë 86
Të lutem më thuaj bir 87
Edhe gjyshërit e vdekur 89
Lejleku 90
Si zgalemat e dëshpëruar 91

Një zë i veçantë si përherë 92
Atje ku përfundojnë fjalët 93
Lotonte trishtimin e një kohe 94
Më fal nëna ime 95
Paskam mbetur 97
Nëpër të cilin vend 99
Me gjasa një korb i zi 100
Ti asnjëherë nuk erdhe 101

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Me natë vijnë lejlekët / Adem Zaplluzha. - Kastriot : Shtëpia Botuese “ Fahri Fazliu”, 2014. - 113 f. ; 21 cm.

Shënime biografike për autorin : f. 103-111

ISBN 978-9951-664-16-5